



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 34 Më 08-01 2023
Br. prot. Dt. RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORTI JANAR – DHJETOR 2022

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

RAPORTI JANAR – DHJETOR 2022

Drejtoria për Administratë

Raporti i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, në vazhdim pasqyron punën e kësaj Drejtorie për periudhën: janar - qershor 2022, punë kjo e realizuar në përputhje me Statutin e Komunës, Planin e Punës, ligjet, rregulloret, udhëzimet dhe vendimet në fuqi.

Si një segment i rëndësishëm i Komunës, ku qytetarët në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre kanë kontakte të drejtpërdrejta me pushtetin komunal po thuaj se çdo ditë. Administrata Komunale, gjatë kësaj periudhe ka bërë përpjekje që të jetë sa më funksionale dhe në pajtim me standardet bashkëkohore, duke ju ofruar qytetarëve të saj, si në aspektin kohor dhe atë cilësor realizim të të drejtave të tyre nga përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës, me kohë maksimale të pritjes 5 minuta, për të gjitha shërbimet që i ofron administrata. Në këtë drejtim fokusi ka qenë realizimi i synimeve programore, respektimi dhe zbatimi i ligjit si dhe akte të tjera juridike, të gjitha këto si parakushte për krijimin e një administrate funksionale dhe efikase, gjithmonë në shërbim të përmbushjes së kërkesave individuale dhe të përgjithshme të qytetarëve, pa asnjë dallim.

Sektori i Teknologjisë Informative

Sektori i Teknologjisë Informative ka vazhduar me zbatimin e planifikimit vjetor të punëve si dhe punëve të përditshme siç janë: monitorimi i rrjetit, sistemeve, përkrahja e zyrtarëve etj.

- Vazhdimisht janë publikuar dokumentet në ueb faqen zyrtare si dhe krijimi i vegëzave sipas kërkesës.
- Është trajnuar stafi për përdorimin e sistemeve/aplikacioneve që përdoren në komunën tonë.
- Janë krijuar llogarit për zyrtarët e rinjë që janë punësuar në komunë..
- Kemi aftësuar zyrën për shërbime kadastrale tek Qendra për shërbime për qytetarë, ku është bërë zgjerimi i rrjetit lokal.
- Është aktivizuar numri i ri jo gjeografik në QKMF.
- Është bërë shtrirja e fijës optike në objektin e ri të DBZHHR.
- Është bërë konfigurimi i VPN-së me asistimin e ASHI-së dhe kyçja në rrjet qeveritar të objektit QKMF-së.
- Janë aktivizuar në objektin e QKMF-së pajisjet për Hyrje – Dalje.
- Është përkrahur çdo mbledhje e mbajtur në sallën e kuvendit Komunal.
- Janë bërë transmetimet e mbledhjeve të kuvendit komunal në ueb faqe.

RAPORTI JANAR – DHJETOR 2022

- Pas ndryshimit të sistemit të gjendjes civile, janë konfiguruar E-kioskat dhe tani janë në funksion.
- Sipas vendimeve të kryetarit të komunës kemi marrë pjesë në hapjen e tenderëve dhe në disa prej tyre edhe jemi caktuar si menaxher kontrate.
- Kemi asistuar në realizimin e disa projekteve si furnizimi dhe montimi i kamerave në objektet shkollë, objektet kulturore, renovimi i objektit të QKMF-së (punimi i rrjetit të brendshëm) etj.
- Në projektin shfrytëzimi i printerëve ku edhe jemi të caktuar si komision për realizimin e kësaj kontrate, vazhdimisht jemi duke e përkrahur kompaninë ArtHouse.
- Me kërkesë të kryetarit kemi filluar në punimin e projektit Rahoveci digjital, ku fillimisht është siguruar materiali për zhvillimin e këtij projekti, përpunimi i këtij materiali, punimi hartave digjitale, dhe finalizimi i këtij projekti dhe si rezultat është krijuar www.rahovecidigjital.com.
- Kemi filluar procedurat për realizimin e projektit One Stop Shop në komunën e Rahovecit, dhe planifikojmë që në tre mujorin e parë të vitit 2023 të finalizohet edhe ky projekt.

Sektori i Gjendjes Civile

Sektori i Gjendje Civile vitin 2022 ka realizuar punët bazuar në ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative mbi dokumentet dhe lëshimin e dokumenteve zyrtare. Ky sektor ka kryer veprime të shërbimit të gjendjes civile siç janë: plotësimi, përditësimi dhe administrimi i regjistrave të gjendjes civile, zhvillimi i procedurave administrative, mbajtja e akteve të gjendjes civile, lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile si dhe veprimeve të tjera juridike administrative në pajtim me legjislacionin në fuqi.

RAPORTI JANAR – DHJETOR 2022

Certifikata e Lindjes	24727	Lindjet Vendore	22
Certifikata e Lindjes pa pagesë	3563	Lindjet e Jashtme	419
Deklarata e Bashkësisë Familjare	3784	Martesarat Vendore	577
Deklarata e Bashkësisë Familjare P.P	999	Martesarat e Jashtme	71
Statusi Martesor	1401	Vdekjet Vendore	82
Statusi Martesor pa pagesë	72	Vdekjet e Jashtme	65
Certifikata e Martesës	4842	Aktvdekjet	169
Certifikata e Martesës pa pagesë	820	Pranimi i atësisë	27
Certifikata e Shtetësisë	284	Aktvendimet e korrigjimit të emrit ose mblemrit	18
Certifikata e Shtetësisë pa pagesë	42	Atvendimet e regjistrimit të mëvonshëm të lindurve	18
Certifikata e Vendbanimit	1370	Atvendimet e regjistrimit të mëvonshëm të vdekurve	1
Certifikata e Vendbanimit pa pagesë	249	Aktvendimet e ndërrimit të emrit dhe mblemrit	15
Certifikata e Vdekjes	1022	Anulimet e regjistrimeve të dyfishuara me aktvendim	10
Certifikata e Vdekjes pa pagesë	186	Aktvendimet e vërtetimit të kurorëzimit	0
Vërtetim nga Arkiva	1263	Fotokopjet nga kartoteka e letërnjoftimeve të ish Jugosllavisë	672
Vërtetim nga Arkiva pa pagesë	180		
Të dëmtuara	809		
Letër e bardhë	1017		

Sektori për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve

Për të gjitha takimet e mbajtura gjatë periudhës një vjeçare janar – dhjetor 2022, është bërë përgatitja profesionale dhe teknike e materialeve, lektorimi, shumëzimi dhe ekspeditivi me kohë i tyre, si dhe janë përcjellë dhe janë mbajtur procesverbale, po ashtu është ofruar ndihmë në mbarëvajtjen e punës së kuvendit, komiteteve dhe komisioneve tjera nga zyrtarët e Zyrës për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve.

Po ashtu në këtë zyre janë përkthyer të gjitha materialet e Kuvendit, Komiteteve, procesverbalet, po ashtu janë përkthyer edhe materialet e ekzekutivit.

Zyra e Kuvendit gjatë periudhës janar – gusht 2022, ka mbajtur kontakte dhe bashkëpunim me Ministrin e Administratës të Pushtetit Lokal, Ministrin e Brendshme si dhe me organet dhe institucionet e tjera, ku ka dërguar raporte në MAPL për aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës.

Në vijim të këtij raporti po ju sjellim në mënyrë tabelare numrin e mbledhjeve të mbajtura bazuar në planin e punës së kuvendit për vitin 2022. Mbledhjet e Kuvendit të rregullta, të jashtëzakonshme, emergjente, solemne dhe komemorative,

RAPORTI JANAR – DHJETOR 2022

Nr.	Kuvendi dhe trupat e tij	Mbledhjet e Kuvendit të rregullta	Të Jashtëzakonshme	Emergjente	Solemne	Komemorative
1.	Numri i takimeve	12	1	0	2	2

Në vijim të këtij Raporti po ju sjellim në mënyrë tabelare numrin e mbledhjeve të komiteteve të mbajtura bazuar në Planin e punës së kuvendit për vitin 2022 : Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbledhjet e Komitetit për Komunitete, mbledhjet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbledhjet e Komitetit të Auditimit, Komitetit për Arsim, Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:

1	Mbledhjet e Komitetit për Politik dhe Financa	11
2	Mbledhjet e Komitetit për Komunitete	6
3	Mbledhjet e KKSB-së	7
4	Komiteti për Arsim	3
	Komiteti për shëndetësi	3
5	Komiteti i Auditimit	5

Në vijim në mënyrë tabelare do ju paraqesim edhe numrin e vendimeve, rregulloreve, planeve dhe informatave që janë shqyrtuar dhe aprovuar në mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të kuvendit komunal Rahovec, për vitin 2022.

	Emërtimet	Nr. Vendimeve	Nr. rregulloreve	Nr. Planeve	Nr. Informatave	Nr. Raporteve	Nr.Statuteve	Konf. Ligjshmërisë nga MAPL
1.	Mbledhjet e Kuvendit të rregullta dhe të jashtëzakonshme	100	2	10	4	9	1	63

RAPORTI JANAR – DHJETOR 2022

Qendra për Shërbime me Qytetarë

Qendra për Shërbim me Qytetarë është pjesë e strukturës organizative të administratës. Përbëhet nga zyrtarët e qendrës për shërbim me qytetarë të cilët kryejnë veprime të shërbimit administrativ si: pranimin e kërkesave/parashtresave nga qytetarët dhe subjektet tjera. Këto kërkesa/parashtresa, të kompletuara përcillen në drejtoritë e administratës komunale, varësisht ku pala parashton për shqyrtim dhe vendosje.

Komunikimin e drejtpërdrejtë, korrekt dhe transparent me qytetarët dhe bizneset, dhënien e ndihmës profesionale për paraqitjen e kërkesave dhe parashtresave, njohja e qytetarëve me informacionet e nevojshme lidhur me kushtet, procedurat administrative, ligjore, afatet kohore të paraqitjes dhe trajtimit të kërkesave dhe parashtresave si në formën klasike ashtu edhe përmes formës elektronike /intranetit, përgatitja dhe vënia në dispozicion të broshurave dhe fletëpalosjeve informative për qytetarët, mbajtja e dosjeve, statistikave të parashtresave dhe kërkesave të paraqitura nga qytetarët, shtypjen e librit të protokollit për kërkesat/parashtresat, vëzhgimi i reagimeve të qytetarëve dhe zyrtarëve të komunës ndaj shërbimeve që ofron qendra etj.

ZKPP	Zyra e Kryetarit, Prokurimi dhe Personeli	113
DAP	Drejtoria për Administratë të Përgjithshme	6,480
DPI	Drejtoria për Punët Inspektuese	153
DFB	Drejtoria për Financa dhe Buxhet	158
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	542
DGJPK	Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	4,240
DSHPKE	Drejtoria për Shërbime Publike Komunale	292
DBZHR	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	1,227
DUPMM	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	315
DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport	141
KKR	Kuvendi Komunal Rahovec	9
DA	Drejtoria për Arsim	284
DEZh	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	129
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	1
		14,084

RAPORTI JANAR – DHJETOR 2022

Sektori për Mirëmbajtje, Logjistikë dhe Sigurim të objekteve

Sektori për mirëmbajtje, logjistikë dhe sigurim të objekteve, brenda kompetencave ka kryer punët rutinore pa ndonjë specifikë, ky sektor është marrë me rregullimin e çështjeve logjistike (pastrim, kujdes për gjelbërim etj...).

Kemi menaxhuar me përkushtim të plotë fushën e logjistikës, ku përfshihet menaxhimi i automjeteve, titullar pronësore i të cilave është Komuna e Rahovecit, duke ushtruar me përkushtim të plotë sipas legjislacionit në fuqi, mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, servisimin, sigurimin dhe regjistrimin e tyre, furnizimin transparent me derivate etj.

Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut

Gjatë vitit 2022 NJKDNJ fillimisht ka bërë plotësimin e pyetësorëve të ndryshëm obligative siç janë i Agjendës Evropiane, ZKIE etj...

Si kryetare e Grupit punues për përgatitjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje, kemi mbajtur 4 takime me Grupin punues dhe tani jemi para finalizimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje.

Kemi qenë pjesëmarrës në disa trajnime – takime online me rëndësi.

Kemi përgatitur raportin kundër diskriminimit ashtu si u kërkua duke i përmbledhur të dhënat e sakta nëpër të gjitha drejtorit sipas indikatorëve të kërkuar dhe e dorëzova në zyrën për qeverisje të mirë.

Me OSBE-në kemi organizuar takimin për formimin e grupit jo formal të grave.

Është mbajtur takim i rregullt me këshilltarin e lartë juridik të Avokatit të Popullit.

Për këtë periudhë kemi pasur dy kërkesa për Ri-Atdhesim.

Është mbajtur tryeza “Adresimi i efekteve afatgjate të dhunës seksuale gjatë luftës dhe anëtareve të familjes së tyre” – Medika Gjakovë.

Kemi marrë pjesë në Punëtorinë dy ditore në Gjakovë për ri-atdhesim si Kryetare e Komisionit Komunal për ri-atdhesim.

Kemi marrë pjesë në konferencë “Sfidat dhe zbatimi i ligjit për mbrojtje nga diskriminimi në nivel qendror dhe lokal”.

Barazia Gjinore

Gjatë vitit 2022 njësia për barazi gjinore ka marrë pjesë në takime dhe aktivitete të ndryshme siç janë ato të Kujdesit Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor (AQH), vizitë në Kooperativën Bujqësore “Krusha” me ftesë të ambasadorit Tomas Szunyoug. “E drejta e grave për trashëgimi në pronë” e organizuar nga SH.P.G. “HAREJA” etj...

RAPORTI JANAR – DHJETOR 2022

Po ashtu kemi marrë pjesë edhe në disa trajnime dhe ligjërata të organizuara nga DEMOS, OSBE, USAID etj...

Indikatori i performancës për drejtorinë e Administratës së Përgjithshme

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME	
Komuna	Rahovec
Referenca	1.1.1
Fusha	SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE
Rezultati	Ofrimi i shërbimeve administrative sipas kërkesave të qytetarëve
Emri i treguesit	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit

1. Gjithsej numri i lëndëve të parashtruara gjatë vitit nga qytetarët dhe palët tjera të interesit – **53899**.
2. Numri i lëndëve të shqyrtuara gjatë një viti nga ana e komunës – **53427 dhe të tjera në proces kanë afat ligjor.**

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME	
Komuna	Rahovec
Referenca	1.1.2
Fusha	SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE
Rezultati	Ofrimi i shërbimeve administrative sipas kërkesave të qytetarëve
Emri i treguesit	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore

1. Numri i lëndëve të shqyrtuara gjatë një viti nga ana e komunës **53427 dhe të tjera në proces kanë afat ligjor.**
2. Numri i lëndëve të cilat janë shqyrtuar brenda afateve të përcaktuar me ligj – N/A

RAPORTI JANAR – DHJETOR 2022

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Komuna	Rahovec
Referenca	1.1.4
Fusha	SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE
Rezultati	Ofrimi i shërbimeve administrative sipas kërkesave të qytetarëve
Emri i treguesit	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna

1. Kërkesa në formë elektronike për certifikatë të lindjes - 29307
2. Kërkesa në formë elektronike për certifikatë të martesës - 5662
3. Kërkesa në formë elektronike për certifikatë të vdekjes - 1208
4. Kërkesa në formë elektronike për certifikatë të shtetësisë - 326
5. Kërkesa në formë elektronike për certifikatë të gjendjes familjare - 4783
6. Kërkesa në formë elektronike për certifikatë të pronës (fleta poseduese) - 3930
7. Fatura e mbeturinave e lëshuar në formë elektronike – N/A, kanë lëshuar vetëm fatura në kopje fizike 82852
8. Fatura për tatimin mbi pronë e lëshuar në formë elektronike – N/A, kemi lëshuar vetëm fatura në kopje fizike dhe numri i faturave të lëshuara është 12504
9. Kërkesa në formë elektronike për leje të ndërtimit - 68
10. Kërkesa në formë elektronike për leje mjedisore - 37

